



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 80, Datë 12.03.2026

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. PËR
KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË
ORIGINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR
CENTRALIN FOTOVOLTAIK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 64/3 prot., datë 10.03.2026 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k.

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, i ndryshuar, për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 50 MW, në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. me shkresën nr. 64/2 prot., datë 12.02.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
- Nga analizimi i dokumentacionit/informacionit të përcjellë, u konstatuan mungesa, ndaj ERE me shkresën nr. 62/5 prot., datë 02.03.2026 i përcolli shoqërisë informacion mbi dokumentacionin që mungonte në këtë aplikim.
- Shoqëria me shkresën nr. 62/7 prot., datë 04.03.2026 ka përcjellë të plotë informacionin e kërkuar/munguar, referuar nenit 6 të rregullores.
- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të centralit fotovoltaik, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, pikën e matjes, etj.
- Sa më sipër rezulton se më parë kjo shoqëri me shkresën nr. 64 prot., datë 08.01.2026 ka përcjellë “Kërkesë për pajisje me GO për impiantin fotovoltaik Nova Solar System”, me specifikimet përkatëse, ku ndër të tjera kërkon lëshimin e Certifikatës së Garancisë së Origjinës

për periudhën kohore 01.10.2024 -31.12.2025. ERE, në përgjigje me shkresën nr. 64/1 prot., datë 29.01.2026, i ka bërë me dije shoqërisë se në zbatim të nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024, se shoqëria duhet të paraqesë në fillim kërkesën për krijimin e një llogarie në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, së bashku me të dhënat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistrë elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se centrali fotovoltaiik për të cilin kërkohet regjistrimi klasifikohet i përshtatshëm për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6 të Rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.
- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistrë si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaiik.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI